



REPUBLICA E KOSOVËS REPUBLICA KOSOVA MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË		UNIVERSITETI UNIVERZITET "HAXHI ZEKA" PEJE
REKTORATI		
Nr. / Br. / No. 801	Nr. i faqj / Br. sh / No. pg 51	
Data / Datum / Date: 23.09.2020		Pejë / Peç

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

UDHËZUES PËR SIGURIMIN E CILËSISË

Prill 2020

QËLLIMI.....	2
HYRJE.....	2
TARGET GRUPI	3
PARIMET	3
FUSHËVEPRIMI I UDHËZUESIT.....	4
KORNIZA E SIGURIMIT TË CILËSISË	4
KËSHILLI I MENAXHIMIT TË CILËSISË DHE VLERËSIMIT.....	6
DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E TRUPAVE TË SIGURIMIT TË CILËSISË.....	6
ZYRA PËR SIGURIM TË CILËSISË DHE VLERËSIM	7
KOORDINATORËT E CILËSISË DHE VLERËSIMIT TË VENDOSUR NË NJËSITË AKADEMIKE TË UHZ-SË ...	8
VLERËSIMI I STAFIT AKADEMIK NGA STUDENTËT	9
VET VLERËSIMI I STAFIT AKADEMIK	11
VLERËSIMI I MESIMDHËNËSIT NGA DEKANI.....	13
VLERËSIMI I ADMINISTRATËS NGA STUDENTËT	15
VLERËSIMI NGA TË DIPLOMUARIT	17
VLERËSIMI NGA PUNËDHËNËSIT	19
VLERËSIMI I PROGRAMEVE.....	22
PROCESI I VLERËSIMIT TË JASHTËM.....	24

HYRJE

Sipas Statutit të Universitetit Haxhi Zeka në Pejë, sigurimi i cilësisë është proces i vlerësimit i cili analizon efikasitetin dhe efektshmërinë e funksionimit të universitetit në të gjitha fushat e veprimit, duke i siguruar njësive të vlerësuara dhe organeve përgjegjëse të qeverisjes treguesit për masat e sigurimit dhe përmirësimit të cilësisë. Sigurimi i cilësisë është një proces i rëndësishëm i cili garanton përmbushjen e kriterëve minimale të cilësisë të vendosura nga universiteti dhe nga mekanizmat e jashtëm të sigurimit të cilësisë.

QËLLIMI

Ky Udhëzues për Sigurimin e Cilësisë është hartuar me qëllim që të udhëzojë të gjithë akterët brenda Universitetit Haxhi Zeka në Pejë për proceset, procedurat, afatet kohore dhe politikatat e sigurimit të cilësisë.

Përmes këtij Udhëzuesi sigurohet:

- mirëmbajtja e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë
- kryerja me efektshmëri të plotë dhe në kohë të procedurave dhe proceseve të sigurimit të cilësisë
- analizimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i sistemit të sigurimit të cilësisë në bazë të vlerësimeve dhe të dhënave të gjeneruara nga vlerësimet
- fillimi i përhapjes së një kulture të sigurimit të cilësisë në mesin e gjithë akterëve të sigurimit të cilësisë
- rritjes së transparencës së veprimeve të trupave përgjegjës për sigurimin e cilësisë.

Ky Udhëzues është hartuar në përputhje me Statutin e Universitetit, me Rregulloren për Sigurimin të Cilësisë, Planin Strategjik të Universitetit si dhe rregulloret e tjera të brendshme të universitetit të cilat lidhen me organizimin e procesit mësimor brenda UHZ.

TARGET GRUPI

Ky dokument i dedikohet gjithë komunitetit akademik të universitetit, me theks të veçantë Zyrës për Sigurimin e Cilësisë, Komisionit Qendror të Sigurimit të Cilësisë, Rektorit dhe Senatit të Universitetit. Dokumenti gjithashtu mund ti shërbejë për informim edhe gjitha palëve të jashtme të cilat janë dhe mund të jenë subjekt i vlerësimeve dhe proceseve të cilësisë së UHZ-së.

PARIMET

Ky udhëzues është i hartuar në frymën e sistemit të sigurimit të cilësisë të implementuar nga Universiteti Haxhi Zeka në Pejë. Gjatë implementimit të këtij udhëzuesi, respektohet parimet e vendosura të sistemit të sigurimit të cilësisë si në vijim:

- proceset e sigurimit të cilësisë brenda universitetit të jenë aktivitete të rregullta që kontribuojnë në zhvillimin e kulturës së cilësisë brenda universitetit
- rezultatet e proceseve të sigurimit të cilësisë të shërbejnë si udhërrëfyes për vendimmarrje dhe planifikim strategjik të universitetit
- secili pjesëtar i komunitetit akademik brenda universitetit është i ndërgjegjësuar për detyrat dhe obligimet e tyre karshi proceseve të sigurimit të cilësisë
- komunitetit akademik është i përfshirë në mënyrë aktive në proceset e sigurimit të cilësisë sidomos stafit akademik, studentëve, industrisë dhe akterëve të tjerë
- transparencës dhe kredibilitetit të proceseve të sigurimit të cilësisë është i rritur

FUSHËVEPRIMI I UDHËZUESIT

Ky udhëzues mbulon fushat e mëposhtme të sigurimit të cilësisë:

Vlerësimi i stafit akademik nga studentët;


1. Vet vlerësimi i stafit akademik
2. Dekani mësimdhënës;
3. Dekani mësimdhënsin
4. Vlerësimi i administratës nga studentët;
5. Vlerësimi i punëdhënësve;
6. Vlerësimi i të diplomuarve;

KORNIZA E SIGURIMIT TË CILËSISË

Sistemi i sigurimit të cilësisë në UHZ është i ndërtuar në përputhje me sistemin e Bolonjës, përkatësisht në përputhje me parimet e Zonës Evropiane të Sigurimit të Cilësisë, me standardet dhe udhëzuesit evropian të sigurimit të cilësisë (ESG), me dispozitat e Ligjit të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës si dhe në përputhje me aktet ligjore të Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) përfshirë UA për Akreditim, Manualin e Akreditimit, etj.

Struktura organizative për Sigurimin e Cilësisë

(1) Organet e Sistemit të Sigurimit të Cilësisë dhe Vlerësimit në UHZ, janë paraqitur në vijim:



(2) Gjitha trupat e mësipërm bashkëpunojnë mes vete për implementimin e sistemin dhe procedurat e sigurimit të cilësisë në të gjitha fushat e aktivitetit të universitetit.

(3) Aktivitetet e sigurimit të cilësisë koordinohen nga Zyra për Sigurim të Cilësisë dhe Vlerësim nën mbikëqyrjen e Këshillit për Menaxhimin dhe Vlerësimin e Cilësisë.

(4) Aktivitetet e sigurimit të cilësisë përcaktohen në një kalendar të aktiviteteve të cilat miratohen nga Senati sipas propozimit të Këshillit Menaxhimit të Cilësisë.

DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E TRUPAVE TË SIGURIMIT TË CILËSISË

KËSHILLI I MENAXHIMIT TË CILËSISË DHE VLERËSIMIT

KMCV është organ këshillues i Senatit dhe Rektorit, i cili në bashkëpunim me organe të tjera mbështetëse dhe profesionale të Universitetit planifikon, monitoron, analizon dhe administron procedurat e vlerësimit të procesit mësimor, hulumtimit shkencor, kërkimit artistik dhe gjitha vlerësimet e fushave të tjera që mbulohen nga universiteti.

Detyrat e Këshillit të Menaxhimit të Cilësisë së janë:

1. I propozon Rektorit dhe Senatit një strategji me udhëzimet e sigurimit të cilësisë dhe vlerësimit, kriteret, standardet dhe procedurat për realizimin e saj dhe përmirësimin e vazhdueshëm;
2. Harton Manualin e Sigurimit të Cilësisë;
3. Harton dhe aprovon planin e aktiviteteve për sigurimin e cilësisë në përputhje me rregullativën në fuqi dhe dokumentet strategjike të UHZ;
4. I dorëzon Rektorit dhe Senatit raport mbi planin e realizuar në aspektin e Sigurimit të cilësisë;
5. I jep sugjerime Rektorit, Senatit, Komisioneve të njësive akademike, për përmirësim të nivelit të cilësisë;
6. Inkurajon diskutimet për cilësinë dhe promovon kulturën e cilësisë brenda universitetit;
7. Analizon të dhënat e mbledhura nga fushat e nenit 2 të kësaj Rregullore;
8. Harton dhe i propozon Senatit aprovimin e raportit e vetëvlerësimit për Ri/Akreditim Institucional;
9. Shqyrton dhe i propozon Senatit aprovimin e raporteve të vetëvlerësimit për Ri/Akreditim të Programeve të Studimit;
10. Në bashkëpunim me menaxhmentin e lartë dhe dekanët zgjedhë anëtarët e komisioneve ad-hoc për realizimin e vlerësimeve sipas nevojës;
11. Harton raporte të përmirësimit në bazë të të dhënave dhe vlerësimeve të pranuar nga Departamenti për Vlerësim dhe Sigurim të Cilësisë;
12. Harton raporte të përmirësimit në bazë të vlerësimeve të Komisioneve ad hoc, të cilat bëjnë vlerësim të brendshëm periodik të programeve aktuale të studimit, dhe ia paraqet Këshillit të Njësive Akademike dhe Menaxhmentit të Lartë;
13. Analizon dhe aprovon raportet periodike/vjetore dhe planet e veprimtarisë së sistemit të sigurimit të cilësisë së njësive akademike të Universitetit, të cilat raporte i dërgon tek Menaxhmenti i Lartë.

ZYRA PËR SIGURIM TË CILËSISË DHE VLERËSIM

Zyra për Sigurim të Cilësisë dhe Vlerësim është zyra qendrore e sigurimit të cilësisë në kuadër të Rektoratit të Universitetit. Zyra për Sigurim të Cilësisë dhe Vlerësim është zyre e pavarur e vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë në kuadër të Universitetit e cila mbikëqyret nga Rektori. Departamenti për Cilësi dhe Vlerësim përbëhet nga:

- Drejtori;
- Zyrta i Cilësisë dhe Vlerësimit;
- Zyrta i për Akreditim.
- Gjithashtu në kuadër të Zyres janë edhe pesë Koordinatorë të cilësisë dhe vlerësimit të vendosur në pesë njësitë akademike të UHZ-së.

Deyrat e Zyres për Sigurim të Cilësisë dhe Vlerësim janë:

1. Zyra është mbështetës i KMCV-së në inicimin dhe koordinimin e iniciativave dhe në zbatimin e vazhdueshëm për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë.
2. Zyra organizon një monitorim sistematik të treguesve të miratuar të cilësisë, veçanërisht aktiviteteve si në vijim:
 - Implementon Planin e Aktiviteteve të sigurimit të cilësisë të aprovuar nga KMSC,
 - Mbledhë informacione për cilësi dhe vlerësim nga të gjithë akterët e sistemit brenda Universitetit,
 - Në bashkëpunim me KMCV dhe Zyrarët për Cilësi dhe Vlerësim organizon procesin e vlerësimit të brendshëm sipas Manualit për Sigurim të Cilësisë, përmes pyetësorëve dhe instrumenteve të tjera të parapara në Manual,
 - Shpërndan pyetësorët, mbledh, përpunon dhe vlerëson të dhënat nga fushat e vlerësuara sipas nenit 2 të kësaj rregullore,
 - Ofron mbështetje për Komisionet Ad Hoc në procesin e vlerësimit të ndryshimeve dhe plotësimeve në programet ekzistuese të studimit, si dhe në procedura të vlerësimit të brendshëm periodik.
 - Ofron mbështetje administrative në procedurat e vlerësimit të brendshëm të sistemit të sigurimit të cilësisë së Universitetit.
 - I ofron mbështetje njësive akademike përmes zyrtarëve për cilësi dhe vlerësim
 - Mbledhë, përpunon dhe analizon të dhënat e nevojshme për përpilimin e raportit vjetor të punës
 - Koordinon punën në mbështetje të njësive akademike për procesin e Ri/Akreditimit institucional dhe të Ri/Akreditimit të programeve të studimit, bazuar në udhëzuesit dhe standardet e AKA-së,
 - Mirëmban dhe i shqyrton dokumentacionin e procesit të ri/akreditimit, përgatitë raporte dhe analiza përkatëse.
3. Për përmbushjen e detyrave të përmendura në këtë nen, Zyra bashkëpunon me të gjithë organet përgjegjëse për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë në Universitetit.
4. Zyra vepron në përputhje me Planin Strategjik të UHZ-së, Strategjinë e Sigurimit të Cilësisë, dhe Planin e aktiviteteve të përcaktuara në Udhëzuesin e Sigurimit të Cilësisë.

KOORDINATORËT E CILËSISË DHE VLERËSIMIT TË VENDOSUR NË NJËSITË AKADEMIKE TË UHZ-SË

Detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatorëve të cilësisë në njësitë akademike janë si në vijim:

- Implementojnë planin e aktiviteteve të sigurimit të cilësisë;
- Mbështesin Zyrën Qendrore të Sigurimit të Cilësisë në lidhje me gjitha aktivitetet dhe proceset e sigurimit të cilësisë;
- Mbledhin informacione për cilësi dhe vlerësim nga të gjithë akterët e sistemit brenda njësisë akademike;
- Mbështesin KMCV-në dhe Zyrën për Sigurim të Cilësisë dhe Vlerësim në organizimin e procesit të vlerësimit të brendshëm sipas Rregullores dhe Manualit për Sigurim të Cilësisë, përmes pyetësorëve dhe instrumenteve të tjera të parapara në Manual;
- Mbështesin Zyrën e Cilësisë për shpërndarjen e pyetësorëve, mbledhjen, përpunimin dhe vlerësimin e të dhënave nga fushat e vlerësuara në njësinë akademike;
- Ofrojnë mbështetje për Komisionet Ad Hoc në procesin e vlerësimit të ndryshimeve dhe plotësimeve në programet ekzistuese të studimit të njësisë akademike;
- Ofrojnë mbështetje administrative në procedurat e vlerësimit të brendshëm të sistemit të sigurimit të cilësisë së njësisë akademike;
- Mbledhin, përpunojnë dhe analizojnë të dhënat e nevojshme për përpilimin e raportit vjetor të punës të njësisë përkatëse akademike;
- Mbështesin Zyrën Qendrore të Cilësisë si dhe KMCV-në për procesin e Ri/Akreditimit të programeve të studimit të njësisë përkatëse akademike
- Të gjitha këto aktivitete i bën në koordinim edhe me Dekanin e njësisë akademike.

VLERËSIMI I STAFIT AKADEMIK NGA STUDENTËT

Zyra përgjegjëse për administrimin e pyetësorit

Departamenti për Cilësisë dhe Vlerësim

Hartimi i rekomandimeve për përmirësim

Këshilli për Menaxhim të Cilësisë dhe Vlerësim

Metodologjia e vlerësimit:

Pyetësorë fizik që shpërndahen në klasa të mësimit

Koha:

Dy herë brenda vitit akademik

Follow up

Raporti përmbledhës me të gjeturat kryesore dhe rekomandimet për përmirësim publikohet në ueb faqen e universitetit

Përshkrimi i procesit

Në javën e fundit të semestrit dimëror, përkatësisht semestrit veror, studentët plotësojnë pyetësorët për të vlerësuar lëndën dhe profesorin e lëndës me rastin e paraqitjes së provimeve. Qëllimi i këtyre pyetësorëve me studentë është vlerësimi i efektshmërisë së procesit mësimor si dhe identifikimi i mangësive për përmirësim në të ardhmen. Zyra për Sigurim të Cilësisë dhe Vlerësim në bashkëpunim me Koordinatorët e sigurimit të cilësisë së njësive akademike, kujdesen që pyetësorët të shpërndahen tek studentët një javë para përfundimit të semestrit përkatës. Shpërndarja e pyetësorëve aktualisht bëhet në forme fizike përmes pyetësorëve në kopje të fortë të cilët shpërndahen në çdo klasë të studentëve. Në të ardhmen e afërt, procesi i shpërndarjes së pyetësorëve dhe mbledhjes së të dhënave do të realizohet në formë elektronike përmes sistemit për menaxhimin e të dhënave të universitetit i cili do të finalizohet në fund të vitit 2020

Para shpërndarjes së pyetësorëve, studentët informohen që:

- pyetësorët janë plotësisht anonim;
- përgjigjet e dhëna në pyetësor nuk do t'i shpalosen ndonjë pale të tretë;
- të dhënat e pyetësorëve shërbejnë vetëm për përdorim të brendshëm të universitetit që kanë për qëllim avancimin e cilësisë së procesit mësimor;
- vlerësimet e studentëve individual apo të klasës nuk do të dërgohen stafit akademik për të cilët studentët kanë plotësuar formularët apo administratës;
- plotësimi i pyetësorëve të jetë i sinqertë dhe objektiv;
- pas mbledhjes dhe analizimit të të dhënave, ata do të njoftohen nga ZSC për rezultatet e pyetësorëve në përgjithësi si dhe për ndërhyrjet që pritet të merren nga menaxhmenti si rezultat i rekomandimeve/ vërejtjeve të studentëve

Pas përfundimit të pyetësorit, ZSCV është përgjegjëse që:

- t'i dërgoj dekanëve të fakulteteve dhe menaxhmentit vlerësimet për gjithë stafin akademik të angazhuar në fakultetin përkatës;
- të gjenerojë rezultatet e vlerësimit dhe të hartojë një raport i cili përmbledh gjetjet kryesore të studentëve, të cilën e dërgon tek Këshilli për Menaxhimin e Cilësisë dhe Vlerësim. Këshilli për Menaxhimin e Cilësisë dhe Vlerësim bën analizimin e të dhënave, harton një raport i cili përmban rekomandimet për përmirësim të cilin e dërgon tek menaxhmenti i lartë për vendimmarrje;
- të dërgojë për publikim raportin përmbledhës me qëllim që palët e interesit të cilat kanë qenë pjesë e vlerësimit të informohen për rezultatet e atij pyetësori.

Secili staf akademik do të pranohet në formë elektronike vlerësimin individual të tij nga Zyra për Sigurimin e Cilësisë dhe Dekani i Fakultetit përkatës. Në bazë të rregullores për vlerësimin e performancës së stafit akademik, aplikohen masat për përmirësimin e rasteve të cilat nuk janë vlerësuar sipas kriteve.

Kalendari i detajuar i aktiviteteve për vlerësimin Studenti => Mësimdhënësin

Semestri dimëror	
05 Janar - 15 Janar i vitit përkatës	Plotësimi i pyetësorit nga studentët para paraqitjes së provimeve për afatin Janar 2020.
16 Janar - 01 Shkurt i vitit përkatës	Gjenerimi i rezultateve të vlerësimeve nga Zyrat e cilësisë të njësive akademike dhe nga Zyra Qendrore e cilësisë.
01 Shkurt - 05 Shkurt i vitit përkatës	Informimi i Dekanit të njësive akademike si dhe stafit akademik me të gjitha rezultatet e arritura lidhur me njësinë akademike.
06 Shkurt - 15 Shkurt i vitit përkatës	Hartimi dhe Aprovimi i Raportit me rezultate të përgjithësuara nga Këshilli Qendror i Cilësisë së UNHZ
16 Shkur i vitit përkatës	Dorëzimi i raportit tek menaxhmenti, dhe publikimi i Raportit të aprovuar për Semestrin dimëror në Web

Semestri veror	
20 Maj - 05 Qërshor i vitit përkatës	Plotësimi i pyetësorit nga studentët para paraqitjes së provimeve për afatin Qershor 2020.
06 Qërshor - 15 Qërshor i vitit përkatës	Gjenerimi i rezultateve të vlerësimeve të mbledhura nga Zyrat e cilësisë të njësive akademike dhe nga Zyra Qendrore e cilësisë.
16 Qërshor - 20 Qërshor i vitit përkatës	Informimi i Dekanit të njësive akademike si dhe stafit akademik me të gjitha rezultatet e arritura lidhur me njësinë akademike.
21 Qërshor - 30 Qërshor i vitit përkatës	Hartimi dhe Aprovimi i Raportit me rezultate të përgjithësuara nga Këshilli Qendror i Cilësisë së UNHZ
1 Korrik i vitit përkatës	Dorëzimi i raportit tek menaxhmenti, dhe Publikimi i Raportit të aprovuar për Semestrin veror në Eëb

VET VLERËSIMI I STAFIT AKADEMIK

Zyra përgjegjëse për administrimin e pyetësorit

Zyra për Sigurim të Cilësisë dhe Vlerësim

Hartimi i rekomandimeve për përmirësim

Këshilli për Menaxhim të Cilësisë dhe Vlerësim

Metodologjia e vlerësimit:

Pyetësorë që shpërndahen në formë elektronike

Koha:

Një herë brenda vitit akademik

Follow up

Raporti përmbledhës me të gjeturat kryesore dhe rekomandimet për përmirësim publikohet në ueb faqen e universitetit

Përshkrimi i procesit

Zyra për Sigurim të Cilësisë dhe Vlerësim ka filluar administrimin e këtij pyetësori në vitin 2020, ndërsa tani ky vlerësim parashihet të bëhet në baza vjetore. Qëllimi i këtij pyetësori është marrja e inputeve nga stafi akademik në lidhje me kënaqshmërinë e tyre për kushtet e punës, për shërbimet administrative dhe mbështetjen teknike gjatë procesit mësimor, për mundësitë që universiteti ju ofron stafit akademik për zhvillimin e tyre profesional dhe personal si dhe për përfshirjen e tyre në proceset e planifikimit dhe vendimmarrjes së universitetit. Secili staf akademik, pavarësisht angazhimit të tyre, part time apo full time, të cilët kanë përfunduar një semestër brenda universitetit do të pranojnë pyetësorin për plotësim. Pyetësori për gjendjen aktuale do të administrohet në formë elektronike përmes një linku të google docs, mirëpo në të ardhmen e afërt parashihet të bëhet përmes platformave elektronike të UHZ pasi të përfundojnë procedurat e avancimit të digjitalizimit të sistemit të universitetit.

Para shpërndarjes së pyetësorëve, Zyra për Sigurim të Cilësisë dhe Vlerësim informon gjithë stafin akademik që:

- pyetësorët janë plotësisht anonim;
- përgjigjet e dhëna në pyetësor nuk do t'i shpalosen ndonjë pale të tretë;
- të dhënat e pyetësorëve shërbejnë vetëm për përdorim të brendshëm të universitetit që kanë për qëllim avancimin e cilësisë së procesit mësimor;
- plotësimi i pyetësorëve të jetë i sinqertë dhe objektiv;
- pas mbledhjes dhe analizimit të të dhënave, ata do të njoftohen nga ZSCV për raportin përmbledhës i cili do të hartohet nga KMCV.

Pas përfundimit të pyetësorit, ZSCV është përgjegjëse që:

- të gjenerojë të dhënat dhe të hartojë një raport i cili përmbledh gjetjet kryesore të vlerësimit, të cilën e dërgon tek Këshilli për Sigurim të Cilësisë dhe Vlerësim Këshilli për Menaxhimin e Cilësisë dhe Vlerësim bën analizimin e të dhënave, harton një raport i cili përmban rekomandimet për përmirësim të cilin e dërgon tek menaxhmenti i lartë për vendimmarrje. ZSCV dërgon të dhënat e vlerësimit edhe tek Zyra për Zhvillim Akademik e cila bën mbledhjen e vlerësimeve të stafit akademik në përputhje me Manualin për Vlerësimin e Performancës së stafit akademik;
- të dërgojë për publikim raportin përmbledhës me qëllim që stafi akademik i cili ka qenë pjesë e vlerësimit të informohen për veprimet e planifikuara nga menaxhmenti.

Qëllimi i vlerësimeve të tilla jo vetëm që shërben për përmirësimin e kushteve të punës si dhe përmirësimin e procesit mësimor, mirëpo shërben edhe si bazë për rishikimin dhe aktualizimin e planeve zhvillimore të stafit akademik. Ky lloj vlerësimi shërben si vlerësim i nevojave të stafit akademik në lidhje me kërkesat e tyre për trajnime, për pjesëmarrje në konferenca shkencore si dhe aktivitete të tjera që kanë për qëllim zhvillimin e vazhdueshëm të stafit akademik.

Kalendari i detajuar i aktiviteteve për vlerësimin: Vetëvlerësimi i stafit akademik

Një herë brenda vitit akademik	
15 Maj – 30 Maj i vitit përkatës	Plotësimi i pyetësorit të vetëvlerësimit nga mësimdhënësit pasi e kanë mbaruar viti akademik.
31 Maj – 15 Qërshor i vitit përkatës	Gjenerimi dhe analizimi i rezultateve të vlerësimeve të mbledhura nga Zyrat e cilësisë të njësive akademike dhe nga Zyra Qendrore e cilësisë.
16 Qërshor – 18 Qërshor i vitit përkatës	Informimi i Dekanit të njësisë akademike me të gjitha rezultatet e arritura lidhur me njësinë e tij akademike.
19 Qërshor – 29 Qërshor i vitit përkatës	Hartimi dhe Aprovimi i Raportit me rezultate të përgjithësuara si dhe rekomandimet për përmirësim nga Këshilli Qendror i Cilësisë së UNHZ
30 Qërshor i vitit përkatës	Dorëzimi i raportit tek menaxhmenti, dhe Publikimi i Raportit të aprovuar për Semestrin veror në Eëb

VLERËSIMI I MESIMDHËNËSIT NGA DEKANI

Zyra përgjegjëse për administrimin e pyetësorit

Zyra për Sigurim të Cilësisë dhe Vlerësim

Hartimi i rekomandimeve për përmirësim

Këshilli për Menaxhim të Cilësisë dhe Vlerësim

Metodologjia e vlerësimit:

Pyetësorë fizik të cilët plotësohen nga Dekani për secilin staf veç e veç

Koha:

Një herë në vit (fundi i vitit akademik)

Follow up

Raporti përmbledhës me të gjeturat kryesore dhe rekomandimet për përmirësim publikohet në ueb faqen e universitetit

Përshkrimi i procesit

Në javën e fundit të semestrit veror, dekanët plotësojnë pyetësorët për të vlerësuar stafin akademik. Qëllimi i këtij pyetësori është që dekani të vlerësojë stafin akademik për përkushtimin në punë, dhe ngritja e cilësisë dhe përgjegjësisë të secili staf akademik.

Zyra për Sigurim të Cilësisë dhe Vlerësim njofton dekanët për kohën e vlerësimit, i cili vlerësim bëhet në formë fizike përmes pyetësorëve në kopje të fortë

Para vlerësimit, stafi informohet për procesin/periudhen e vlerësimit. Stafit i garantohet që:

- përgjigjet e dhëna në pyetësor nuk do t'i shpalosen ndonjë pale të tretë;
- të dhënat e pyetësorëve shërbejnë vetëm për përdorim të brendshëm të universitetit që kanë për qëllim avancimin e cilësisë në punë;
- vlerësimet individuale do t'i dërgohen secilit staf veç e veç dhe Zyres për Zhvillim Akademik dhe Përsosmëri në Mësimdhënie, për nxjerrje të performancës së stafit ;
- plotësimi i pyetësorëve do të jetë i sinqertë dhe objektiv;
- pas vlerësimit, ata do të njoftohen nga dekani për rezultatet përkatëse të cilat do të nënshkruhen nga secili staf i vlerësuar.

Dekani pas vlerësimit fton secilin staf akademik në mënyrë individuale për ta njoftuar me vlerësimin, i cili vlerësim nënshkruhet nga vlerësuesi dhe i vlerësuar.

Pas vlerimit të realizuar nga dekanët, ZSCV është përgjegjëse që:

- Të mbledhë vlerësimet nga të gjitha njësitë akademike dhe të gjenerojë rezultatet e vlerimit dhe të hartojë një raport i cili përmbledhë gjetjet kryesore, të cilin e dërgon tek Këshilli për Menaxhimin e Cilësisë dhe Vlerësim. Vlerësimet individuale i dërgohen Zyrës për Zhvillim Akademik dhe Përsosmëri në Mësimdhënie.
- Ndërsa, Këshilli për Menaxhimin e Cilësisë dhe Vlerësim bën analizimin e të dhënave, harton një raport i cili përmban rekomandimet për përmirësim të cilin e dërgon tek menaxhmenti i lartë për vendimmarrje;
- të dërgojë për publikim raportin përmbledhës.

Shënim: Rezultatet individuale dhe raportet përmbledhëse, nga vlerësimet e realizuara përmes pyetësorëve: Studenti Mësimdhënësin, Vetëvlerësimi, Dekani Mësimdhënësin, i dërgohen Zyrës për Zhvillim Akademik dhe Përsosmëri në Mësimdhënie, e cila duke u bazuar në këto tre vlerësime nxjerrë performancën e stafit akademik, bazuar në Manualin për vlerësim të performancës së stafit akademik, në bazë të cilit manual aplikohen masat për përmirësimin e rasteve të cilat nuk janë vlerësuar sipas kritereve.

Kalendari i detajuar i aktiviteteve për vlerësimin: Dekani Mësimdhënësin

Një herë brenda vitit akademik	
15 Maj – 30 Maj i vitit përkatës	Plotësimi i pyetësorit Dekani Mësimdhënësin pasi e kanë mbaruar vitin akademik.
31 Maj – 15 Qërshor i vitit përkatës	Gjenerimi dhe analizimi i rezultateve të vlerësimeve të mbledhura nga Zyrat e cilësisë të njësive akademike dhe nga Zyra Qendrore e cilësisë.
16 Qërshor – 18 Qërshor i vitit përkatës	Informimi i Zyres për Zhvillim Akademik dhe Përsosmëri në Mësimdhënie, me të gjitha rezultatet e arritura lidhur me vlerësimin nga Dekanët.
19 Qërshor – 29 Qërshor i vitit përkatës	Hartimi dhe Aprovimi i Raportit me rezultate të përgjithësuara si dhe rekomandimet për përmirësim nga Këshilli Qendror i Cilësisë së UNHZ
30 Qërshor i vitit përkatës	Dorëzimi i raportit tek menaxhmenti, dhe Publikimi i Raportit të aprovuar për Semestrin veror në Eëb

VLERËSIMI I ADMINISTRATËS NGA STUDENTËT

Zyra përgjegjëse për administrimin e pyetësorit

Zyra për Sigurim të Cilësisë dhe Vlerësim

Hartimi i rekomandimeve për përmirësim

Këshilli për Menaxhim të Cilësisë dhe Vlerësim

Metodologjia e vlerësimit:

Pyetësorë fizik që shpërndahen në klasa të mësimi

Koha:

Dy herë brenda vitit akademik

Follow up

Raporti përmbledhës me të gjeturat kryesore dhe rekomandimet për përmirësim publikohet në ueb faqen e universitetit

Përshkrimi i procesit

Në javën e fundit të semestrit dimëror, përkatësisht semestrit veror, studentët plotësojnë pyetësorët për të vlerësuar administratën e universitetit me rastin e paraqitjes së provimeve. Qëllimi i këtyre pyetësorëve me studentë është mbledhja e inputeve në lidhje me atë se sa janë të kënaqur studentët me shërbimet administrative dhe mbështetjen e tyre për procesin mësimor. Zyra për Sigurim të Cilësisë dhe Vlerësim në bashkëpunim me Koordinatorët e sigurimit të cilësisë dhe vlerësim, të njësive akademike, kujdesën që pyetësorët të shpërndahen tek studentët një javë para përfundimit të semestrit përkatës, bashkërisht me pyetësorët për vlerësimin e stafit akademik. Shpërndarja e pyetësorëve aktualisht bëhet në formë fizike përmes pyetësorëve në kopje të fortë të cilat shpërndahen në çdo klasë të studentëve. Në të ardhmen e afërt, procesi i shpërndarjes së pyetësorëve dhe mbledhjes së të dhënave do të realizohet në formë elektronike përmes sistemit për menaxhimin e të dhënave të universitetit i cili do të finalizohet në fund të vitit 2020. Para shpërndarjes së pyetësorëve, studentët informohen që:

- pyetësorët janë plotësisht anonim;
- përgjigjet e dhëna në pyetësor nuk do t'i shpalosen ndonjë pale të tretë;
- të dhënat e pyetësorëve shërbejnë vetëm për përdorim të brendshëm të universitetit që kanë për qëllim avancimin e cilësisë së procesit mësimor;
- plotësimi i pyetësorëve të jetë i sinqertë dhe objektiv;
- pas mbledhjes dhe analizimit të të dhënave, ata do të njoftohen nga ZSCV për rezultatet e pyetësorëve në përgjithësi si dhe për ndërhyrjet që pritet të merren nga menaxhmenti si rezultat i rekomandimeve/ vërejtjeve të studentëve

Pas përfundimit të pyetësorit, ZSCV është përgjegjëse që:

- t'i dërgoj Sekretarit të Përgjithshëm dhe dekanëve të fakulteteve dhe menaxhmentit të lartë vlerësimet për shërbimet administrative;
- të gjenerojë rezultatet e vlerësimeve dhe të hartojë një raport i cili përmbledh gjetjet kryesore të studentëve, të cilin e dërgon tek Këshilli për Menaxhimin e Cilësisë dhe Vlerësim. Këshilli për Menaxhimin e Cilësisë dhe Vlerësim bën analizimin e të dhënave, harton një raport i cili përmban rekomandimet për përmirësim të cilin e dërgon tek menaxhmenti i lartë për vendimmarje;
- të dërgojë për publikim raportin përmbledhës me qëllim që palët e interesit të cilat kanë qenë pjesë e vlerësimit të informohen për rezultatet e atij pyetësori.

Çdo pjesëtar i administratës do të ketë qasje në raportin përmbledhës të vlerësimit të shërbimeve administrative. Vlerësimi i studentëve për administratën përpos që shërben për përmirësimin e kushteve teknike dhe administrative për studentë, i kontribuon gjithashtu edhe vlerësimit të administratës krahas vlerësimit të tyre sipas dispozitave të ligjit për shërbyesit civil.

Kalendari i detajuar i aktiviteteve për vlerësimin: Studenti => Administratën

Semestri dimëror dhe Semestri veror	
05 Janar – 15 Janar i vitit përkatës	Anketimi në fund të semestrit dimëror dhe atij veror me rastin e paraqitjes së provimeve.
20 Maj – 05 Qërshor i vitit përkatës	
16 Janar – 01 Shkurt i vitit përkatës 06 Qërshor – 15 Qërshor i vitit përkatës	Gjenerimi dhe Analizimi i rezultateve të vlerësimeve të mbledhura nga Zyrat e cilësisë të njësive akademike dhe nga Zyra Qendrore e cilësisë.
01 Shkurt – 05 Shkurt i vitit përkatës 16 Qërshor – 20 Qërshor i vitit përkatës	Informimi i Sekretarit të Përgjithshëm, Dekani
06 Shkurt – 15 Shkurt i vitit përkatës 21 Qërshor – 30 Qërshor i vitit përkatës	Hartimi dhe Aprovimi i Raportit me rezultate të përgjithësuara dhe rekomandimet për përmirësim nga Këshilli Qendror i Cilësisë së UNHZ
16 Shkurt i vitit përkatës	Dorëzimi i raportit tek menaxhmenti, dhe Publikimi i Raportit të aprovuar për Semestrin veror në Eëb
01 Korrik i vitit përkatës	Dorëzimi i raportit tek menaxhmenti, dhe Publikimi i Raportit të aprovuar për Semestrin veror në Eëb

VLERËSIMI NGA TË DIPLOUARIT

Zyra përgjegjëse për administrimin e pyetësorit

Zyra për Sigurim të Cilësisë dhe Vlerësim

Hartimi i rekomandimeve për përmirësim

Këshilli për Menaxhim të Cilësisë dhe Vlerësim

Metodologjia e vlerësimit:

Pyetësorë që shpërndahen në formë elektronike

Koha:

Një herë brenda vitit akademik

Follow up

Raporti përmbledhës me të gjeturat kryesore dhe rekomandimet për përmirësim publikohet në ueb faqen e universitetit

Përshkrimi i procesit

UHZ ka filluar vlerësimin sistematik të të diplomuarve të universitetit. Ani pse universiteti ka të funksionalizuar Zyrën e Karrierës e cila merret me komunikimin dhe bashkëpunimin me studentët e diplomuar, duke iu ofruar atyre shërbime të ndryshme, trajnime, etj, vlerësimi me të diplomuarit nga ZSCV është një instrument i rëndësishëm për mbledhjen e informatave kthyesë në lidhje me programet e studimit të ofruara nga universiteti. Studentët vlerësojnë se sa janë të kënaqur me aftësitë, shkathtësitë dhe kompetencat e fituara gjatë studimeve në UHZ, si dhe sa korrespondon punësimi i tyre me fushën e studimit në universitet. Të diplomuarit gjithashtu japin rekomandimet e tyre në lidhje me atë se cilat lëndë më së shumti i kanë ndihmuar që të kuptojnë dhe realizojnë detyrat e punës në praktikë, si dhe cilat prej lëndëve nuk do të duhej të ishin pjesë e programit të studimit të tyre në të ardhmen.

Pyetësori administrohet një herë brenda vitit akademik nga Zyra për Sigurim të Cilësisë dhe Vlerësim, ndërsa Zyra e Karrierës së Universitetit mbështet Zyrën për Cilësi në lidhje me kontaktet e të diplomuarve. Departamenti i Cilësisë në bashkëpunim me Zyrën e Karrierës, kujdesen që pyetësorët të shpërndahen tek të diplomuarit një herë brenda vitit akademik. Shpërndarja e pyetësorëve aktualisht bëhet në formë elektronike përmes platformave google docs, mirëpo në të ardhmen e afërt, ky proces do të realizohet në formë elektronike përmes sistemit për menaxhimin e të dhënave të universitetit i cili do të avancohet deri në fund të vitit 2020.

Para shpërndarjes së pyetësorëve, të diplomuarit informohen që:

- pyetësorët janë plotësisht anonim;
- përgjigjet e dhëna në pyetësor nuk do t'i shpalosen ndonjë pale të tretë;
- të dhënat e pyetësorëve shërbejnë vetëm për përdorim të brendshëm të universitetit që kanë për qëllim avancimin e cilësisë së procesit mësimor;
- plotësimi i pyetësorëve të jetë i sigurtë dhe objektiv;
- pas mbledhjes dhe analizimit të të dhënave, ata do të njoftohen nga ZSCV për rezultatet e pyetësorëve në përgjithësi, si dhe për ndërhyrjet që pritet të merren nga menaxhmenti si rezultat i rekomandimeve/ vërejtjeve të studentëve.

Pas përfundimit të pyetësorit, ZSCV është përgjegjëse që:

- të gjenerojë rezultatet e vlerësimit dhe të hartojë një raport i cili përmbledh gjetjet kryesore të të diplomuarve, të cilin e dërgon tek Këshilli për Sigurimin të Cilësisë dhe Vlerësim. Këshilli për Menaxhimin e Cilësisë dhe Vlerësim bën analizimin e të dhënave, harton një raport i cili përmban rekomandimet për përmirësim të cilin e dërgon tek menaxhmenti i lartë për vendimmarrje.
- të dërgojë për publikim raportin përmbledhës me qëllim që palët e interesit të cilat kanë qenë pjesë e vlerësimit të informohen për rezultatet e atij pyetësori

Kalendari i detajuar i aktiviteteve për vlerësimin të diplomuarit => Universitetin

Një herë brenda vitit akademik	
10 Shtator – 05 Tetor i vitit përkatës	Pavarësisht kontaktit të rregullt të mirëmbajtur nga Qendra e Karrierës dhe mbledhja e informatave kthyesë nga ta në mënyrë të vazhdueshme, anketimi i studentëve të diplomuar nga DSC realizohet një herë brenda vitit akademik.
06 Tetor – 20 Tetor i vitit përkatës	Gjenerimi dhe analizimi i rezultateve të vlerësimeve të mbledhura nga Zyrat e cilësisë të njësive akademike dhe nga Zyra Qendrore e cilësisë.
21 Tetor – 30 Tetor i vitit përkatës	Informimi i Dekanit të njësisë akademike dhe Zyrave përkatëse me të gjitha rezultatet e arritura lidhur me njësinë e tij akademike si dhe menaxhmentit të lartë.
31 Tetor – 15 Nëntor i vitit përkatës	Hartimi dhe Aprovimi i Raportit me rezultate të përgjithësuara si dhe rekomandimet për përmirësim nga Këshilli Qendror i Cilësisë së UNHZ
16 Nëntor i vitit përkatës	Dorëzimi i raportit tek menaxhmenti, dhe Publikimi i Raportit të aprovuar për Semestrin veror në Eëb

VLERËSIMI NGA PUNËDHËNËSIT

Zyra përgjegjëse për administrimin e pyetësorit

Zyra për Sigurim të Cilësisë dhe Vlerësim

Hartimi i rekomandimeve për përmirësim

Këshilli për Menaxhim të Cilësisë dhe Vlerësim

Metodologjia e vlerësimit:

Pyetësorë që shpërndahen në formë elektronike

Koha:

Një herë brenda vitit akademik

Follow up

Raporti përmbledhës me të gjeturat kryesore dhe rekomandimet për përmirësim publikohet në ueb faqen e universitetit

Përshkrimi i procesit

Komunikimi dhe bashkëpunimi i vazhdueshëm me punëdhënësit dhe industrinë është njëri ndër objektivat kryesore strategjike të Universitetit. Qëllimi i bashkëpunimit me punëdhënësit është marrja e inputeve të tyre në lidhje me cilësinë e të diplomuarve të Universitetit si dhe kontributin e universitetit për përgatitjen e tyre në tregun e punës. UHZ krahas themelimit dhe funksionalizimit të Bordeve Industriale, ka paraparë disa forma të komunikimit me punëdhënësit dhe marrjen e informatave kthyesë nga ta në lidhje me programet e studimit sikurse përmes: organizimeve të ndryshme për punëdhënësit sikurse Panairi i karrierës; realizimi i projekteve të përbashkëta me UHZ; organizimi i debateve me studentë për tema të caktuara; gjatë organizimeve të ndryshme të anketimeve nga studentët që punojnë në punimin e diplomës, apo të pjesës së hulumtimit të tyre në lidhje me tregun e punës, etj. Megjithatë, vlerësimi përmes pyetësorit mundëson që secili punëdhënës të japë inputet e tyre saktësisht në lidhje me aftësitë dhe kompetencat e të diplomuarve dhe të ofrojë rekomandime konkrete se çka duhet universiteti të ndryshojë në programet e studimit në mënyrë që të adresohen më mirë kërkesat e tregut të punës.

Zyra për Sigurim të Cilësisë dhe Vlerësim ka filluar administrimin e këtij pyetësori në vitin 2020 ndërsa tani ky vlerësim parashihet të bëhet në baza vjetore. Pyetësori për gjendjen aktuale administrohet në formë elektronike përmes një linku të google docs, mirëpo në të ardhmen e afërt parashihet të bëhet përmes platformave elektronike të UHZ pasi të përfundojnë procedurat e avancimit të digjitalizimit të sistemit të universitetit.

Para shpërndarjes së pyetësorëve, Zyra për Sigurim të Cilësisë dhe Vlerësim sigurohet për këto veprime:

- kërkon nga secili dekan i njësisë akademike identifikimin e punëdhënësve të të diplomuarve;
- pas marrjes së listës së punëdhënësve, kontaktohen njësitë relevante të cilat merren me burimet njerëzore për të dërguar adresën në të cilin pyetësi i universitetit duhet të shpërndahet;
- pyetësi i shpërndahet saktësisht mbikëqyrësit të studentit të diplomuar i cili është i informuar për punën e realizuar nga studenti i diplomuar dhe nuk lejohet të dërgohet në adresa të përgjithshme të firmës/ biznesit apo institucionit;
- personave të cilët iu dërgohet pyetësi duhet ti sqarohet qëllimi i pyetësit;
- punëdhënësit duhet të sigurohen se pyetësorët janë plotësisht anonim dhe se përgjigjet e dhëna në pyetësor nuk do t'i shpalosen ndonjë pale të tretë;
- punëdhënësit duhet të sigurohen se të dhënat e pyetësorëve shërbejnë vetëm për përdorim të brendshëm të universitetit që kanë për qëllim avancimin e cilësisë së procesit mësimor;
- punëdhënësve duhet ti kërkohet që plotësimi i pyetësorëve të jetë i sinqertë dhe objektiv;
- punëdhënësit duhet të sigurohen se pas mbledhjes dhe analizimit të të dhënave, ata do të pranojnë një raport zyrtar nga universiteti në lidhje me të gjeturat e vlerësimit si dhe veprimet e planifikuara nga menaxhmenti për përmirësim/ ndryshim.

Pas përfundimit të pyetësit, ZSCV është përgjegjëse që:

- të gjenerojë rezultatet e vlerësimit dhe të hartojë një raport i cili përmbledh gjetjet kryesore të vlerësimit, dhe të njëjtën e dërgon tek Këshilli për Sigurim të Cilësisë dhe Vlerësim. Këshilli për Menaxhimin e Cilësisë dhe Vlerësim bën analizimin e të dhënave, harton një raport i cili përmban rekomandimet për përmirësim të cilin e dërgon tek menaxhmenti i lartë për vendimarrje;
- të dërgojë për publikim raportin përmbledhës me qëllim që punëdhënësit të cilët kanë qenë pjesë e vlerësimit të informohen për veprimet e planifikuara nga menaxhmenti.

Qëllimi i vlerësimeve të tilla shërben që trupat përgjegjëse brenda universitetit dhe njësive akademike të marrin parasysh të gjeturat e vlerësimeve të punëdhënësve gjatë hartimit të programeve të reja dhe rishikimit të programeve ekzistuese. Në këtë mënyrë universiteti siguron se programet e studimit janë në harmoni të plotë me kërkesat e tregut të punës.

Kalendari i detajuar i aktiviteteve për vlerësimin Punëdhënësi => Universitetin

Një herë brenda vitit akademik	
01 Mars - 14 Mars i vitit përkatës	Vlerësimi i studentëve të diplomuar të cilët janë të punësuar në tregun e punës
15 Mars - 31 Mars i vitit përkatës	Gjenerimi dhe Analizimi i rezultateve të vlerësimeve të mbledhura nga Zyrat e cilësisë të njësive akademike dhe nga Zyra Qendrore e cilësisë.
01 Prill - 04 Prill i vitit përkatës	Informimi i Dekanit të njësive akademike dhe Zyrave përkatëse me të gjitha rezultatet e arritura lidhur me njësinë e tij akademike.
05 Prill - 20 Prill i vitit përkatës	Hartimi dhe Aprovimi i Raportit me rezultate të përgjithësuara dhe me rekomandimet për përmirësim nga Këshilli Qendror i Cilësisë së UNHZ
21 Prill i vitit përkatës	Dorëzimi i raportit tek menaxhmenti, dhe Publikimi i Raportit të aprovuar për Semestrin veror në Eëb

VLERËSIMI I PROGRAMEVE

Zyra përgjegjëse për administrimin e pyetësorit

Zyra për Sigurim të Cilësisë dhe Vlerësim

Hartimi i rekomandimeve për përmirësim

Këshilli për Menaxhim të Cilësisë dhe Vlerësim

Metodologjia e vlerësimit:

Pyetësorë që shpërndahen në formë elektronike, komisione ad hoc dhe fokus grupe

Koha:

Së paku një herë brenda tri viteve

Follow up

Raporti përmbledhës me të gjeturat kryesore dhe rekomandimet për përmirësim publikohet në ueb faqen e universitetit

Përshkrimi i procesit

Vlerësimi i programit bëhet me propozim nga Këshilli për Menaxhim të Cilësisë dhe Vlerësim, përmes Komisioneve ad hoc, të cilët komisione, sipas Rregullores për sistemin e sigurimit të cilësisë dhe vlerësimit të UHZ-së, neni 8 paragrafi 1.10, në bashkëpunim me menaxhmentin e lartë dhe dekanët zgjedhë anëtarët e komisioneve ad hoc për realizimin e vlerësimeve sipas nevojës. Komisionet ad hoc vlerësimin e programeve mund të bëjnë përmes:

- Pyetësorëve me studentë
- Intervistimi përmes fokus grupeve
- Evidentimi i pjesëmarrjes së studentëve në ligjërata
- Kalueshmëria e studentëve
- Vlerësimi i syllabuseve
- Regjistrimi i studentëve në raport me numrin e shpallur për aplikim, dhe formave të tjera, varësisht nga programi i vlerësuar.

Në rastin e vlerësimit përmes pyetësorëve, Zyra për Sigurim të Cilësisë në bashkëpunim me koordinatoret e sigurimit të cilësisë së njësive akademike, kujdesen që pyetësorët të shpërndahen tek palët e vlerësuara duke i njoftuar paraprakisht ata me arsyen dhe qëllimin e vlerësimit. Shpërndarja e pyetësorëve aktualisht bëhet në forme fizike përmes pyetësorëve në kopje të fortë mirëpo në të ardhmen e afërt, procesi i shpërndarjes së pyetësorëve dhe mbledhjes së të dhënave do të realizohet në formë elektronike përmes sistemit për menaxhimin e të dhënave të universitetit i cili do të finalizohet në fund të vitit 2020.

Në rast se Zyra për Sigurim të Cilësisë pranon përmes Pro Rektorit për Bashkëpunim Ndërkombëtarë dhe Sigurim të Cilësisë apo nga ndonjë nivel tjetër i menaxhmentit të universitetit, ankesa të raportuara në lidhje me procesin mësimor nga studentët apo stafi akademik, Zyra përmes koordinatorëve të cilësisë administron vlerësimin në formë të intervistimit të një grupi të studentëve në lidhje me çështjen e ngritur apo me stafin akademik i cili është subjekt i ankesës. Në çdo rast, Zyra duhet të përkujdeset që palët e vlerësuar të informohen në detaje për arsyen dhe qëllimin e vlerësimit si dhe duhet të sigurohen se rezultatet e atyre vlerësimeve përdoren për qëllime të brendshme të zyrës.

Zyra e Cilësisë mund të autorizohet nga KMCV për analizimin e raporteve të kalueshmërisë së studentëve për programe të caktuara, aty ku potencialisht mund të raportohet për nivel të ulët të kalueshmërisë së studentëve apo nivel të ulët të diplomimit. Zyra mund të bëjë mbledhjen e të dhënave dhe analizimin e trendëve nga një vit në vitin tjetër, krahasimin me programe të tjera të studimit brenda njësisë akademike, dhe të nxjerrë konkluzione në lidhje me programin e caktuar të studimit.

Vlerësimi i syllabuseve është një element tjetër i cili mund të vlerësohet nga Zyra për Sigurim të Cilësisë. Në bazë të Rregullores së Sistemit të Sigurimit të Cilësisë parashihet formimi i komisioneve ad hoc, që në këtë rast mund të ngarkohen me vlerësimin e syllabuseve të cilat mund të jenë tematike apo mund të jenë të përgjithshme. Komisioni mund të vlerësojë specifikisht rezultatet e të nxënit, apo të vlerësojë dyfishimet e përmbajtjeve në mes të lëndëve apo niveleve të ndryshme apo të vlerësojë nivelin e kompetencave, aftësive dhe shkathtësive të studentëve në bazë të përshkruesve të KKK-së.

Në secilin rast, Zyra obligohet vetëm për mbledhjen dhe gjenerimin e të dhënave dhe dërgimin e raporteve përmbledhëse me gjetjet kryesore tek Komisioni për Menaxhimin e Cilësisë i cili pastaj bën analizimin e të dhënave dhe harton një raport me rekomandime të cilin e dërgon tek Rektori (menaxhmenti i lartë). Në rast se përmes vlerësimeve të mësipërme konstatohet se një program i caktuar ka rezultuar me ngecje apo është evidentuar që duhet të ketë përmirësime, Rektori duke u bazuar në pikën 1.2, paragrafi 1, të nenit 97, të Statutit të UHZ-së, kërkon nga Komisioni i Studimeve të bëjë rishikim të programit.

Sipas nenit 97 të Statutit të UHZ-së, Komisioni i studimeve është përgjegjës për:

- hartimin e propozimeve të programeve të reja të studimeve;
- përshtatjen dhe ndryshimin e programeve ekzistuese të studimit;
- rishikimin e vazhdueshëm të teksteve universitare;
- kërkesat për ndërrimin e programeve të studimeve nga studentët;
- kërkesat për 'studium irregulare' nga studentët;
- përgatitjen e lëndës për ankesat e studentëve.

PROCESI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Zyra përgjegjëse për administrimin e pyetësorit

Zyra për Sigurim të Cilësisë dhe Vlerësim

Harton/Shqyrton raportet e vlerësimit të jashtëm

Këshilli për Menaxhim të Cilësisë/Senati

Koha:

Së paku një herë brenda tri viteve

Përshkrimi i procesit

Në bazë të Rregullores për Sistemin e Sigurimit dhe Vlerësim të Cilësisë, Vlerësimet e jashtme bëhen nga autoritetet shtetërore të cilat me ligj njihen si autoritete të vlerësimit të jashtëm sikurse Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA) ose ndonjë agjenci tjetër ndërkombëtare e cila njihet sipas dispozitave të Ligjit të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës. Procesi i vlerësimit të jashtëm në Kosovë është procesi i akreditimit i cili është proces ciklik i detyrueshëm për të gjitha institucionet e arsimit të lartë në Kosovë, dhe aplikohet në nivel të programeve dhe nivel institucional. Varësisht nga periudha e kohëzgjatjes së akreditimit, 3 apo 5 vite, Universiteti duhet paraprakisht ti nënshtrohet një vlerësimi të brendshëm në bazë të Standardeve dhe Udhëzuesve të AKA-së (Manualit të Akreditimit). Gjithë procesi i akreditimit organizohet në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë, Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e IAL-ve, Manualin e AKA-së si dhe Standardet dhe Udhëzuesit Evropian për Sigurim të Cilësisë (ESG).

Njëra prej detyrave kryesore të Zyrës për Sigurim të Cilësisë dhe Vlerësim në raport me procesin e akreditimit është respektimi i afateve ligjore të përcaktuara në UA për Akreditim në lidhje me aplikimin për akreditim:

- Deklarimi i bartësve të programit
- Deklarimi i stafit akademik për procesin e akreditimit (më së largu 30 tetor të vitit përkatës akademik)
- Dorëzimi i aplikacioneve për akreditim në AKA (më së largu 30 tetor të vitit përkatës akademik)
- Mbështetë KMCV-në në hartimin e raportit të vet vlerësimit për programet e studimit apo për nivelin institucional i cili dorëzohet në AKA më së voni një muaj pas aprovimit formal të aplikacionit nga KSHC.
- Mbështetë menaxhmentin dhe KMCV-në në hartimin e planeve për zbatimin e rekomandimeve pas marrjes së vendimit për akreditim në bazë të kohës së përcaktuar në vendimin e KSHC-së.
- Çdo kërkesë tjetër ad hoc e cila adresohet në UHZ nga menaxhmenti i AKA-së apo KSHC-së

Zyra për Sigurimit të Cilësisë dhe Vlerësim është përgjegjëse për mbledhjen e të dhënave nga çdo njësi akademike në lidhje me dhënat të për akreditim që kanë të bëjnë me programet e studimit, syllabuset, stafin akademik, punën kërkimore të stafit akademik, pjesëmarrjen dhe organizimin e konferencave shkencore/ artistike, dhe çdo të dhënë dhe statistikë tjetër në lidhje me suksesin e studentëve, përqindjen e kalueshmërisë së tyre, diplomimit etj. Zyra është përgjegjëse që të kërkojë nga njësitë akademike përmes koordinatorëve të cilësisë, që çdo njësi akademike të bëjë planin e punës për implementimin e rekomandimeve të dhëna nga panelet e akreditimit të cilat pastaj duhet të reflektohen në raportin e procedurës së ri akreditimit. Duke qenë se përmbushja e rekomandimeve nga ekspertët ndërkombëtarë është njëri nga kriteret kyçe për akreditim, Zyra për Sigurimit të Cilësisë dhe Vlerësim në bashkëpunim me koordinatorët për cilësi, kujdesën që gjitha këtë rekomandime të adresohen në raportet e vlerësimit.

Hartimi i raporteve të vlerësimit për procesin e akreditimit do të jetë proces transparent dhe gjithëpërfshirës i cili përfshin akterët kryesor akademik, sidomos stafit akademik dhe studentët.

Raporti i vet vlerësimit në nivel institucional hartohet nga KMCV dhe aprovohet nga Senati. Ndërsa, Raportin e vet vlerësimit për ri/akreditim të programeve të studimit i cili hartohet nga bartësit, KMCV e shqyrton dhe i propozon Senatit për aprovim.

Shtojca 1.



I dedikuar për cilësi, standarde dhe suksese
Dedicated for quality, standards and excellences
Posvecen kualitetu, standardima i uspjehu

Pyetësoni i vlerësimit: Studenti – Mësimdhënësin

SEMESTRI... 2019/2020

Të nderuar studentë,

Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë, ju fton që të plotësoni këtë pyetësor, i cili ka për qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies së studentëve. Ju lutem, përgjigjet tuaja të jenë të sinqerta, sepse vetëm në këtë mënyrë ne do të arrijmë të identifikojmë sfidat e mundshme brenda Universitetit dhe do të bëjmë përpjekje për t'i larguar ato.

Ju njoftojmë se plotësimi i këtij pyetësori është plotësisht anonim. Përgjigjet tuaja do të përdoren vetëm nga menaxhmenti i lartë i Universitetit dhe nuk do t'i shpalosen asnjë pale tjetër.

Ju falënderojmë shumë për bashkëpunimin tuaj!

Fakulteti *

Fakulteti i Biznesit
Fakulteti Juridik
Fakulteti MTHM
Fakulteti i Agrobiznesit
Fakulteti i Arteve

Fakulteti i Biznesit**Programi i studimit ***

Administrim Biznesi - Bachelor
Administrim Biznesi (gjuhë boshnjake) - Bachelor
Kontabilitet dhe Financa - Bachelor
Administrim Biznesi (gjuhë boshnjake) - Master
Kontabilitet dhe Financa - Master
Menaxhim i Burimeve Njerëzore - Master

Fakulteti i Arteve

Edukim i Përgjithshëm në Muzikë - Bachelor
Edukim në Muzikë - Bachelor
Edukim Artistik në Instrumente Frymore - Bachelor
Regji Filmi dhe TV - Bachelor

Fakulteti Juridik**Programi ***

Juridik i Përgjithshëm - Bachelor

Fakulteti MTHM**Programi ***

Menaxhment në Turizëm dhe Hotelieri - Bachelor
Menaxhim i Turizmit (gjuhë boshnjake) - Bachelor

Fakulteti i Agrobiznesit**Programi ***

Teknologji e Prodhimit Bimor - Bachelor
 Agroekologji dhe Agromjedis - Bachelor
 Teknologji Ushqimore - Bachelor

Të dhëna:**Viti i studimeve ***

Viti i dytë

Viti i tretë

Viti i katërt

Mësimdhënësi/Asistenti ***Lënda *****Pyetjet për Mësimdhënësin ***

Ju lutem, jepni përgjigjet tuaja në shkallë nga 1 deri në 5 (1* dobët, 2* mjaftueshëm, 3* mirë, 4* shumë mirë, 5* shkëlqyeshëm)

A	Pyetje për mësimdhënësin	Dobët	Mjaftueshëm	Mirë	Shumë mirë	Shkëlqyeshëm
1	Mësimdhënësi është i përgatitur për lëndën	1	2	3	4	5
2	Mësimdhënësi është i qartë në ligjërata	1	2	3	4	5
3	Mësimdhënësi është transparent	1	2	3	4	5
4	Mësimdhënësi është i drejtë në vlerësim	1	2	3	4	5
5	Mësimdhënësi është i saktë në orë	1	2	3	4	5
6	Mësimdhënësi është kreativ në zhvillimin e mësimin dhe aktivitetëve tjera	1	2	3	4	5
7	Mësimdhënësi krijon aktivitete që e bëjnë lëndën më të kuptueshme	1	2	3	4	5
8	Mësimdhënësi inkurajon bashkëpunimin dhe pjesëmarrjen e studentëve	1	2	3	4	5
9	Studenti lirshëm mund t'i bëjë pyetje mësimdhënësit	1	2	3	4	5
10	Mësimdhënësi kërkon interaktivitet gjatë ligjëratave	1	2	3	4	5
11	Sjellja e mësimdhënësit është në përputhje me rregulloren	1	2	3	4	5
12	Mësimdhënësi është gjithmonë në dispozicion për konsultime	1	2	3	4	5

B	Pyetje për lëndën	Dobët	Mjaftueshëm	Mirë	Shumë mirë	Shkëlqyeshëm
1	Përmbajtja e planprogramit është në përputhje me literaturën bashkëkohore	1	2	3	4	5
2	Qëllimi dhe objektivi i lëndës është definuar qartë në syllabusin e lëndës	1	2	3	4	5
3	Ligjëratat vijohen në përputhje me planprogramin	1	2	3	4	5
4	Materialet e lëndës janë të disponueshme	1	2	3	4	5
5	Lënda është organizuar në mënyrë të atillë që më ka ndihmuar të kuptoj konceptet e lëndës	1	2	3	4	5
6	Materialet e lëndës (literatura, ligjëratat, sllajdet, etj.) kanë ndikuar në zhvillimin e njohurive dhe aftësive në fushën përkatëse	1	2	3	4	5
7	Aktivitetet vlerësuese (teste, prezantime, punime, etj.) më kanë ndihmuar të kuptoj më mirë materialet/konceptet e lëndës	1	2	3	4	5
8	Testet dhe provimi përfshijnë materialet që janë shtjelluar në klasë	1	2	3	4	5
9	Ambienti në orën mësimore inkurajon shprehje të mendimeve/ideve	1	2	3	4	5
10	Struktura e vlerësimit është e drejtë dhe e përshtatshme	1	2	3	4	5

C	SUGJERIME DHE VËREJTJE
1	Çka ju ka pëlqyer më së shumti te lënda apo te mësimdhënësi?
2	Çka do të ndryshonit te kjo lëndë apo te mësimdhënësi?
3	Komente të lira

JU FALEMINDERIT PËR KOHËN E KUSHTUAR NË PLOTËSIMIN E KËTIJ PYETËSORI!

Shtojca 2



I dedikuar për cilësi, standarde dhe suksese
Dedicated for quality, standards and excellences
Posvecen kualitetu, standardima i uspjehu

Pyetësor për Vetëvlerësimin e Stafit Akademik

SEMESTRI... 2019/2020

Të nderuar staf akademik,

Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë, është duke zgjeruar fushëveprimin e proceseve të sigurimit të cilësisë, me qëllim që të bëhen vlerësime më gjithëpërfshirëse në lidhje me performancën e stafit akademik si dhe çështjeve të tjera të cilat lidhen me mësimdhënien, mësimnxënien dhe punën kërkimore-shkencore.

Në këtë drejtim, UHZ ka përgatitur këtë pyetësor i cili ka për qëllim që të identifikojë fushat potenciale për përmirësimin dhe zhvillimin e stafit akademik.

Rezultatet e këtij pyetësori do të shërbejnë për përdorim të brendshëm dhe nuk do t'i shpalosen asnjë pale të tretë.

Faleminderit për bashkëpunimin tuaj!

1. Statusi i të punësuarit

- Staf i rregullt
- Staf i angazhuar

2) Vetëvlerësimi i stafit akademik

Ju lutem, jepni përgjigjet tuaja në shkallë nga 1 deri në 5 (1* dobët, 2* mjaftueshëm, 3* mirë, 4* shumë mirë, 5* shkëlqyeshëm)

	Kushtet e punës	Dobët	Mjaftueshëm	Mirë	Shumë mirë	Shkëlqyeshëm
1	Unë jam i/e kënaqur me kushtet e punës të ofruara nga Universiteti	1	2	3	4	5
2	Unë gjej mbështetje të menaxhmenti për çdo vështirësi dhe sfidë eventuale	1	2	3	4	5
3	Ngarkesa ime e punës është lehtë e menaxhueshme	1	2	3	4	5
4	Unë jam në dijeni për misionin, vizionin dhe qëllimet strategjike të Universitetit	1	2	3	4	5
5	Unë marrë pjesë në proceset politikëbërëse dhe vendimmarrëse të Universitetit	1	2	3	4	5
6	Unë jam i/e lirë të shpreh idetë e mia dhe propozimet të menaxhmenti i UHZ-së	1	2	3	4	5
7	Hapësira e Universitetit plotëson të gjitha kushtet e nevojshme për realizimin e mësimi efektiv	1	2	3	4	5
8	Hapësira është e furnizuar me pajisje adekuatë (projektor, tabelë, banka, karrige, etj)	1	2	3	4	5
9	Stafi akademik ka qasje të lehtë në shërbimet teknike aty kur kërkohet	1	2	3	4	5

3	Mësimdhënia dhe zhvillimi personal	Dobët	Mjaftueshëm	Mirë	Shumë mirë	Shkëlqyeshëm
1	Unë arrij që të prezantoj në mënyrë të saktë qëllimin dhe objektivat e planprogramit	1	2	3	4	5
2	Unë menaxhoj me lehtësi provimet dhe vlerësimet e studentëve	1	2	3	4	5
3	Unë përdor metodologji bashkëkohore të mësimdhënies	1	2	3	4	5
4	Numri i studentëve në sallë është i përshtatshëm për realizimin e procesit mësimor	1	2	3	4	5
5	Unë ndjehem i/e motivuar për punën time si mësimdhënës në UHZ	1	2	3	4	5
6	Unë ndjehem i integruar brenda Universitetit					
7	UHZ organizon mjaftueshëm konferenca shkencore për stafin akademik	1	2	3	4	5
8	UHZ organizon mjaftueshëm aktivitete të cilat kanë synim zhvillimin e stafit akademik	1	2	3	4	5
9	Unë jam i/e kënaqur me mundësitë e ofruara nga UHZ, për zhvillimin tim personal	1	2	3	4	5

4	Administrata	Dobët	Mjaftueshëm	Mirë	Shumë mirë	Shkëlqyeshëm
1	Komunikimi me administratën është efektiv	1	2	3	4	5
2	Sjellja e zyrtarëve administrativ është korrekte dhe profesionale	1	2	3	4	5
3	Çdo kërkesë e imja përmbushet në kohë të shpejtë nga shërbimi administrativ	1	2	3	4	5
4	Administrata është gjithmonë në dispozicion për sqarime shtesë dhe asistencë	1	2	3	4	5
5	Unë informohen me kohë nga administrata për çdo ndryshim të orarit të ligjëratave, provimeve apo procesit mësimor	1	2	3	4	5

5. Ju lutem numëroni tre sfidat kryesore me të cilat potencialisht përballeni në UHZ:

- 1.
- 2.
- 3.

6. Ju lutem numëroni tre elemente të cilat mendoni se duhet të përmirësohen nga Universiteti për përmirësimin e kushteve të punës dhe performancës tuaj:

- 1.
- 2.

JU FALEMINDERIT PËR KOHËN E KUSHTUAR NË PLOTËSIMIN E KËTIJ PYETËSORI!

Shtojca 3



I dedikuar për cilësi, standarde dhe suksese
Dedicated for quality, standards and excellences
Posvećen kvalitetu, standardima i uspjehu

Pyetësori i vlerësimit: Dekani - Mësimdhënësin

SEMESTRI DIMËROR 2019/2020

Qëllimi i këtij pyetësi është që dekani të vlerësojë stafin akademik për përkushtimin në punë, dhe ngritja e cilësisë dhe përgjegjësisë të secili akademik.

1. Fakulteti *

2. Emri dhe mbiemri i profesorit/asistentit *

Ju lutem, jepni përgjigjet tuaja në shkallë nga 1 deri në 5 (1* dobët, 2* mjaftueshëm, 3* mirë, 4* shumë mirë, 5* shkëlqyeshëm)

A	Pyetje për mësime	Dobët	Mjaftueshëm	Mirë	Shumë mirë	Shkëlqyeshëm
1	Mësime kryen obligimet me ndërgjegje, me kohë dhe në mënyrë kualitative	1	2	3	4	5
2	Mësime ka aftësi për të planifikuar, organizuar dhe koordinuar aktivitete brenda njësisë akademike	1	2	3	4	5
3	Mësime është i gatshëm për llogaridhënie ndaj Dekanit	1	2	3	4	5
4	Mësime është i gatshëm të marrë përgjegjësi për realizimin e detyrave (jashtë mësime dhe hulumtimit) brenda Universitetit	1	2	3	4	5
5	Mësime është aktiv në punime shkencore/artistike, konferenca dhe aktivitete tjera që kontribuojnë në avancimin e tij	1	2	3	4	5
6	Mësime është i rregullt në ligjërata dhe nuk bën mungesa	1	2	3	4	5
7	Mësime ka marrëdhënie të mira me studentët dhe kolegët tjerë	1	2	3	4	5
8	Mësime është bashkëpunues me administratën dhe dekanatin	1	2	3	4	5
9	Mësime mbanë rregullisht konsultime me studentë	1	2	3	4	5
10	Mësime organizon aktivitete jashtë-kurrikulare për studentët (vizita në industri, punë praktike, vizita në institucionet relevante për lëndën e tij, etj)	1	2	3	4	5

11. Mësimdhënësi është i përfshirë në komisionet e themeluara brenda Universitetit ? Po
Jo

12. Studentët kanë pasur ankesa ndaj mësimdhënësit Po Jo

13. A është paraqitur ndonjëherë mësimdhënësi në komision disiplinor (brenda vitit akademik)?
Po Jo

14 | **Komente shitesë:**

JU FALEMINDERIT PËR KOHËN E KUSHTUAR NË PLOTËSIMIN E KËTIJ PYETËSORI!



I dedikuar për cilësi, standarde dhe suksese
Dedicated for quality, standards and excellences
Posvecen kualitetu, standardima i uspjehu

Pyetëtori i vlerësimit: Studenti – Administratën

SEMESTRI DIMËROR 2019/2020

Qëllimi i këtyre pyetësorëve me studentë është mbledhja e inputeve në lidhje me atë se sa janë të kënaqur studentët me shërbimet administrative dhe mbështetjen e tyre për procesin mësimor.

Fakulteti _____

ADMINISTRATA OFRON SHËRBIME EFIKASE TË DOBISHME ADMINISTRATIVE

Ju lutem, jepni përgjigjet tuaja në shkallë nga 1 deri në 5 (1* dobët, 2* mjaftueshëm, 3* mirë, 4* shumë mirë, 5* shkëlqyeshëm)

A	Pyetjet për administratën	Dobët	Mjaftueshëm	Mirë	Shumë mirë	Shkëlqyeshëm
1	Komunikimi me administratën	1	2	3	4	5

	është korrekt, i saktë dhe profesional					
2	Administrata tregon sjellje të mirë në raport me studentët	1	2	3	4	5
3	Kërkesat e studentëve përmbushen gjithmonë nga zyrtarët përkatës të administratës	1	2	3	4	5
4	Administrata është në dispozicion për sqarime	1	2	3	4	5
5	Kërkesat e studentëve merren parasysh me kohë sipas rregulloreve dhe Statutit	1	2	3	4	5
6	Administrata ka aftësi për të kryer punë me shumë palë në të njëjtën kohë	1	2	3	4	5
7	Administrata pranon dhe përfundon me kohë dokumentacionin e studentëve në afatin e provimeve, diplomimeve dhe kërkesave tjera (vendime, vërtetime, certifikata, sems, etj) ¹	1	2	3	4	5

Pyetje shtesë:

1. Përshtypja juaj për punën e zyrtarëve të administratës

2. A keni ndonjë sugjerim për përmirësimin e punës së administratës?

3. Komente shtesë rreth detyrave të zyrtarëve të administratës rreth plotësimit të kërkesave tuaja

¹ Vërejtje: Në momentin e plotësimit të këtij pyetësi studenti duhet të respektoj nenin 144 dhe 149 të Statutit të Universitetit.

¹ Shënim: Vendosja e notave në SEMS për diplomime, si dhe nënshkrimi i kërkesave të ndryshme nuk varet vetëm nga administrata.

JU FALEMINDERIT PËR KOHËN E KUSHTUAR NË PLOTËSIMIN E KËTIJ PYETËSORI

Shtojca 5



I dedikuar për cilësi, standarde dhe suksese
Dedicated for quality, standards and excellences
Posvecen kualitetu, standardima i uspjehu

Pyetësor i vlerësimit: Për të Diplomuarit

Të nderuar studentë të diplomuar,

Me qëllim të krijimit të rrjetit të të diplomuarve (Alumni), dhe me qëllim të mirëmbajtjes së kontakteve dhe komunikimit me të diplomuarit, Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë, ka hartuar këtë pyetësor i cili do t'i ndihmojë Universitetit të përmirësojë programet e studimit. Vlerësimet nga studentët e diplomuar janë të vlefshme për të vlerësuar përvojën e studentëve në UHZ dhe identifikimin e fushave për përmirësim për gjeneratat e ardhshme të studentëve.

Ju njoftojmë se plotësimi i këtij pyetësori është plotësisht anonim, rezultatet e tyre shërbejnë vetëm për përdorim të brendshëm dhe nuk do t'i shpalosen asnjë pale të tretë.

Ju falënderojmë shumë për bashkëpunimin tuaj!

1. Pjesa e edukimit

Fakulteti në të cilin keni studiuar? *

- Fakulteti i Biznesit
- Fakulteti Juridik
- Fakulteti i Menaxhimit në Turizëm, Hotelieri dhe Mjedis
- Fakulteti i Agrobiznesit
- Fakulteti i Arteve

Programi / Studimet *

Shënoni programin dhe studimet në nivelin Bachelor

Shënoni vitin e regjistrimit

Shënoni vitin e diplomimit

Nëse keni vazhduar studimet Master, plotësoni pyetjen e mëposhtme, nëse jo, vazhdoni në pyetjen tjetër

Shënoni programin dhe studimet në nivelin Master

Shënoni vitin e diplomimit

2) INFORMATA PËR STUDENTËT E DIPLOMUAR

1. Gjinia

Femër

Mashkull

2. Moshë

18-25

25-30

35-40

45-50

3. Pjesa e punësimit

A jeni punësuar pas diplomimit? *

Po

Jo

Kam hapur biznes personal

Nëse po, shënoni se ku punoni?

Shënoni se çfarë ndërmarrje apo institucioni jeni punësuar?

Nëse po, shënoni pas çfarë kohe nga diplomimi jeni punësuar?

A është i lidhur punësimi juaj direkt me fushën e studimit?

Është i lidhur

Është mesatarisht i lidhur

Nuk është aspak i lidhur

Cila është pozita juaj brenda institucionit ku jeni punësuar?

Pozitë menaxheriale e nivelit të lartë

Pozitë menaxheriale e nivelit të mesëm

Pozitë menaxheriale

Pozitë profesionale

Pozitë administrative

Pozitë teknike

Pozitë shërbyese

Nëse jo, pse nuk jeni punësuar:

Nuk kam pasur sukses në konkurse

Mendoj që jam më i kualifikuar se sa vendet e lira të punës

Kam qëllim të vazhdoj studimet akademike

Tjetër (ju lutëm specifikoni)

A jeni të kënaqur deri me tani me vendin tuaj të punës?

Po

Jo

4) VLERËSIMI PËR SHKATHTËSITË E FITUARA GJATË STUDIMIT NË UHZ

Ju lutem, jepni përgjigjet tuaja në shkallë nga 1 deri në 5 (1* dobët, 2* mjaftueshëm, 3* mirë, 4*

shumë mirë, 5* shkëlqyeshëm)

A	Ju lutem, jepni vlerësimin tuaj se sa jeni të kënaqur me aftësitë dhe shkathhtësitë e fituara gjatë studimeve tuaja në UHZ	Dobët	Mjaftueshëm	Mirë	Shumë mirë	Shkëlqyeshëm
1	Të menduarit kritik dhe analitik	1	2	3	4	5
2	Njohuritë specifike për vendin e punës	1	2	3	4	5
3	Aftësitë për zgjidhjen e problemeve	1	2	3	4	5
4	Aftësi për punë kërkimore dhe hulumtuese	1	2	3	4	5
5	Mbledhjen dhe interpretimin e të dhënave	1	2	3	4	5
6	Aftësitë komunikuese, komunikimin verbal dhe me shkrim	1	2	3	4	5
7	Njohuritë dhe përdorimin e gjuhës angleze	1	2	3	4	5

8	Njohuritë dhe përdorimin e teknologjisë informative	1	2	3	4	5
9	Punën ekipore dhe nën presion të kohës	1	2	3	4	5
10	Sjelljen etike dhe vlerat morale	1	2	3	4	5

5. Nëse do t'iu duhet të zgjedhni programin tuaj të studimit në institucionin aktual për herë të dytë:

- Do ta zgjedhja të njëjtin program studimi dhe universitetin përsëri
- Do të zgjedhja të njëjtin program por në një universitet tjetër
- Do të zgjedhja një program tjetër studimi
- Nuk do të shkoja në të njëjtin universitet përsëri

6. A do të ja rekomandonit këtë program të studimit studentëve të tjerë? Po Jo

7. Shënoni lëndët të cilat ju kanë ndihmuar më së shumti që t'i kuptoni dhe realizoni detyrat e punës në praktikë

8. Shënoni lëndët që ju konsideroni që nuk duhet të jenë pjesë e programit tuaj të studimit në të ardhmen

Koment i lirë i të diplomuarit:

JU FALEMINDERIT PËR KOHËN E KUSHTUAR NË PLOTËSIMIN E KËTIJ PYETËSORI!



I dedikuar për cilësi, standarde dhe suksese
Dedicated for quality, standards and excellences
Posvecen kualitetu, standardima i uspjehu

Pyetësori i vlerësimit: Për Punëdhënësin

Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë, duke synuar që të rrisë bashkëpunimin me industrinë, ka hartuar këtë pyetësor i cili ka për qëllim që të vlerësojë se sa janë të kënaqur punëdhënësit me të diplomuarit e Universitetit të Pejës.

Rezultatet e këtij pyetësori do të shërbejnë për të harmonizuar sa më shumë përmbajtjet e programeve të studimit me kërkesat e tregut të punës, si dhe për të bërë rishikimet e nevojshme, me qëllim që të diplomuarit e UHZ-së të jenë sa më të përgatitur për tregun e punës.

Ju njoftojmë se plotësimi i këtij pyetësori është plotësisht anonim, përgjigjet tuaja konsiderohen vetëm për përdorim të brendshëm dhe nuk do t'i shpalosen asnjë pale të tretë.

Ju falënderojmë për bashkëpunimin tuaj!

Gjinia e të punësuarve

Femra

Meshkuj

Mosha e të punësuarve
45/50

18/25

25/30

30/35

35/40

40/45

Ju lutem, jepni përgjigjet tuaja në shkallë nga 1 deri në 5 (1* dobët, 2* mjaftueshëm, 3* mirë, 4* shumë mirë, 5* shkëlqyeshëm)

A	INFORMATA PËR TË DIPLOMUARIT	Dobët	Mjaftueshëm	Mirë	Shumë mirë	Shkëlqyeshëm
1	A jeni të kënaqur me të diplomuarit e UHZ-së?	1	2	3	4	5
2	A mendoni se planprogrami studimor i ka aftësuar të diplomuarit për vendin e tyre të punës?	1	2	3	4	5
3	A tregojnë aftësi të mjaftueshme të diplomuarit që të kuptojnë nevojat tuaja të punës?	1	2	3	4	5

4. A ofroni trajnime shtesë për të diplomuarit me rastin e punësimit të tyre? Po Jo

5. Nëse po, a janë këto trajnime:

- Specifike (ju lutem shpjegoni arsyen pse janë specifike)
- Të përgjithshme (ju lutem shpjegoni arsyen pse janë të përgjithshme)
- Tjetër (ju lutem shpjegoni arsyet)

6. Cilat lëndë apo aftësi, shkathtësi dhe kompetenca, rekomandoni të shtohen në programin e studimit që të diplomuarit të jenë më të përgatitur për të kryer me sukses detyrat e punës?

- 1.
- 2.
- 3.

INFORMATA SPECIFIKE

B	Sa jeni të kënaqur me të diplomuarit e UHZ-së, specifikisht sa i përket:	Dobët	Mjaftueshëm	Mirë	Shumë mirë	Shkëlqyeshëm
1	Të menduarit kritik dhe analitik	1	2	3	4	5


2	Njohuritë specifike për vendin e punës	1	2	3	4	5
3	Aftësi për zgjidhjen e problemeve	1	2	3	4	5
4	Aftësi për punë kërkimore dhe hulumtuese	1	2	3	4	5
5	Aftësi kreative dhe inovative	1	2	3	4	5
6	Mbledhjen dhe interpretimin e të dhënave	1	2	3	4	5
7	Aftësi komunikuese (verbale dhe me shkrim)	1	2	3	4	5
8	Njohuritë dhe përdorimin e gjuhës angleze	1	2	3	4	5
9	Njohuritë dhe përdorimin e teknologjisë informative	1	2	3	4	5
10	Punën ekipore dhe nën presion të kohës	1	2	3	4	5
11	Sjelljen etike dhe vlerat morale	1	2	3	4	5

12. Cilat aftësi, kompetenca dhe shkathtësi mendoni se ju mungojnë të diplomuarve të UHZ-së?

- 1.
- 2.
- 3.

C	Sa jeni të kënaqur me kontributin e të diplomuarve të UHZ-së?	Dobët	Mjaftueshëm	Mirë	Shumë mirë	Shkëlqyeshëm
1	Për organizatën tuaj	1	2	3	4	5
2	Për komunitetin	1	2	3	4	5
3	Për shoqatat profesionale	1	2	3	4	5

Koment i përgjithshëm nga punëdhënësi



JU FALEMINDERIT PËR KOHËN E KUSHTUAR NË PLOTËSIMIN E KËTIJ PYETËSORI!